



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.793/7 prot.

Datë 14.04.2025

V E N D I M

Nr. 498/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiovent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK” dhe “Jubica” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-10941-06-24-2024, me objekt “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” (ndarë në 15 lote), me fond limit 2,966,127,447 (dy miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë gjashtë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSH ose 29,584,355.14 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë katërmëdhjetë) Euro pa TVSH, Loti 1, me Nr. REF-10943-06-24- 2024, me objekt të lotit: “Mirëmbajtje me performancë

rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)”, me fond limit të lotit 319,256,430 (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH ose 3,184,285.16 (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk (përfaqësues) me NIPT L46827004L dhe adresë: Shkodër, Rruga “Daut Boriçi”, zona kadastrale nr. 8594, numri i pasurisë 3/574+2-22, volumni 36, faqe 14 & “VARAKU E” Shpk me NIPT J61902509S dhe adresë: Rruga Xhafzotaj-Durrës.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.06.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-10941-06-24-2024, me objekt “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” (ndarë në 15 lote), Fondi limit i përgjithshëm / vlera e pritshme e kontratës: 2,966,127,447 (dy miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë gjashtë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSH. Në Euro: 29,584,355.14 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë katërmëdhjetë) Euro pa TVSH, Numri i referencës së **Lotit 1: REF-10943-06-24-2024 me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)”** (gjatësia totale 64.3 km), me vlerë totale **319,256,430** (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 3,184,285.16** (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar më datë 02.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datë 29.07.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit).

1. JUBICA SHPK
2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK
3. ROZAF 94
4. I.D.K-KONSTRUKSION

II.3. Në datën 20.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ku rezulton se BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK, është i skualifikuar.

- | | |
|--|----------------|
| 1. JUBICA SHPK | I Kualifikuar |
| 2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK | I Skualifikuar |
| 3. ROZAFI 94 | I Skualifikuar |
| 4. I.D.K-KONSTRUKSION | I Skualifikuar |

II.4. Me datë 29.10.2024, në Vendimin nr.1515/2024 datë 29.10.2024 Komisioni vendosi:

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-10943-06-24-2024, me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me fond limit 319,256,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt – ankimi.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi si dhe Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në lidhje bashkimit të operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk.

4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk.

6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

8.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.5. Në datën 01.11.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për rivlerësimin e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ku rezulton se BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK, është i kualifikuar pas zbatimit të vendimit të KPP-së nr.1515/2024 datë 29.10.2024.

- | | |
|--|---------------|
| 1. JUBICA SHPK | I Kualifikuar |
| 2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK | I Kualifikuar |

II.6. Në datë 12.11.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar ftesën për tender, për fazën e dytë, të procedurës së mësipërme të prokurimit duke iu drejtuar operatorëve ekonomikë të kualifikuar:

1. JUBICA SHPK
2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK

II.6.1. Në datë 02.12.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e dytë, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

1. JUBICA SHPK
2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK

II.6.2. Në datë 13.12.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e propozimeve ekonomiko-teknike dhe dhënien e pikëve operatorëve ekonomikë të kualifikuar në këtë fazë, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

- | | |
|--|---------------|
| 1. JUBICA SHPK | 296,9994 pikë |
| 2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK | 297 pikë |

II.7. Në datë 24.12.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 90, datë 30.12.2024, ku është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK

II.8. Në datën 30.12.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 3788/2024, datë 18.12.2024 dhe numër elektronik A/2024/4940, datë 30.12.2024, e operatorit ekonomik “JUBICA” SHPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3788/2 prot., datë 31.12.2024 ku u konstatua se, objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi shpalljen fitues në procedurën e shortit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK”, si dhe kundërshtimin e vlerësimit me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK”, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Më datë 06.01.2025, operatori ekonomik “JUBICA” SHPK ka dërguar “Formular ankese”, nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar ankesa me nr. 3788/3, datë 06.01.2025.

II.11. Më datë 07.01.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, ka depozituar pranë KPP-së, “Formular Argumentesh”, nëpërmjet postës elektronike, protokolluar me nr. 3788/4, datë 07.01.2025.

II.12. Më datë 09.01.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK”, ka depozituar pranë KPP-së, “Formular Argumentesh”, nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me nr. 3788/5, datë 09.01.2025.

II.13. Në datën 10.01.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga operatori ekonomik “JUBICA” Shpk me nr. Aplikimi A/2024/4940, të paraqitur në Sistemin e Ankesave Elektronike”, të protokolluar me tonën me nr. 3788/6 prot, datë 10.01.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e **ka pranuar pjesërisht** ankesën e ankimuesit.

II.14. Me shkresën nr. 3788/7 prot., datë 15.01.2025, KPP iu drejtuar autoritetit kontraktor ARRSH, nëse BOE “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” SHPK si subjekt i interesuar, ka dorëzuar apo jo “Formular Argumentesh”, pranë autoritetit kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar? A e keni njoftuar BOE “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” SHPK si subjekt i interesuar, mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Jubica”SHPK? Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.

II.15. Me shkresën përcjellëse me nr. 189/1 prot., datë 13.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3788/8 prot., datë 16.01.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacioni nëpërmjet shërbimit postar.

II.16. Me shkresën nr. 3788/9 prot., datë 27.01.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor për ti kërkuar informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave për çdo fazë, procesverbali i hedhjes së shortit, si dhe të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “JUBICA” SHPK, të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.17. Me shkresën përcjellëse me nr. 473/1 prot., datë 27.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3788/10 prot., datë 29.01.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse “Kthim përgjigje”, në lidhje me shkresën nr. 3788/7 prot., datë 15.01.2025 të KPP-së.

II.18. Me shkresën përcjellëse me nr. 784/1 prot., datë 06.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 3788/11 prot., datë 10.02.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse “Kthim përgjigje”, në lidhje me shkresën nr. 3788/9 prot., datë 27.01.2025 të KPP-së.

II.19. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, janë paraqitur argumentet nga BOE i interesuar “Varaku E & Ndërtuesi 2014” SHPK, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, nëpërmjet adresës elektronike të KPP-së si dhe shërbimit postar, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.20. Në datë 03.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.325/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “JUBICA” Shpk, për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-10943-06-24-2024, me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me fond limit 319,256,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.21. Me shkresën nr. 2006/1 prot., datë 21.03.2025, protokolluar me tonën nr. 3788/17 prot., datë 21.03.2025, autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 325/2025, datë 03.03.2025, si vijon: “...Referuar shkresës tuaj nr. 3788/15 prot., datë 03.03.2025 me lëndë “dërgim Vendimi”, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)”, me Nr. REF-10943-06-24-2024, po ju dërgojmë procesverbalin mbi rivlerësimin e propozimit ekonomiko-teknik, nga komisioni i vlerësimit të ofertave”.

-procesverbal nr. 5 datë 21.03.2025 mbi rivlerësimin e ofertave të paraqitura;

II.22. Në datë 03.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.325/2025, ku vendosi:

1. Autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.325/2025, datë 03.03.2025.
2. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës të prokurimit prokurimit, Loti 1, me Nr. REF-10943-06-24- 2024, me objekt të lotit:

“Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)”, me fond limit të lotit 319,256,430 (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH ose 3,184,285.16 (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) Euro pa TVSH zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar, deri në shqyrtimin e plotë të ankesës së subjektit të interesuar të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk.

3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë*

II.23. Në datën 25.03.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 793/2025, datë 25.03.2025 dhe numër elektronik A/2025/5179, datë 25.03.2025, e nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK” në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.24. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 793/1 prot., datë 26.03.2025 ku u konstatua se, nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vlerësimit me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK” dhe operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.25. Më datë 06.01.2025, operatori ekonomik “JUBICA” SHPK ka dërguar “Formular i paraqitjes së argumentave”, ardhur nëpërmjetë sistemit elektronik, protokolluar me nr. 793/2 prot., datë 02.04.2025.

II.26. Me shkresën me nr. 793/3 prot., datë 02.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor, ku referuar pikës 4 të nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke i kërkuar informacion lidhur mbi vendimin e marrë mbi trajtimin e ankesës.

II.27. Me shkresën nr. 2846/1 prot., datë 08.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 793/4 prot., datë 10.04.2025, autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje shkresës me nr. 793/3 prot., datë 02.04.2025 duke argumentuar se: “.....ju bëjmë me dije se, ankesa nuk është marrë në konsideratë, pasi autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësim të procedurës në përputhje dhe në zbatim të plotë të Vendimit nr. 325/2025 datë 03.03.2025 të KPP-së, duke efaktuar dhe dokumentuar me shkresën nr. 2006/1 prot., datë 21.03.2025, me lëndë “Zbatim vendimi”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK me nr. 793 prot., datë 25.03.2025, të paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 25.06.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike*”, me Nr. REF-10941-06-24-2024, me objekt “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” (ndarë në 15 lote), Fondi limit i përgjithshëm / vlera e pritshme e kontratës: 2,966,127,447 (dy miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë gjashtë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSH. Në Euro: 29,584,355.14 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë katërmëdhjetë) Euro pa TVSH, Numri i referencës së **Lotit 1: REF-10943-06-24-2024 me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)”** (gjatësia totale 64.3 km), me vlerë totale **319,256,430** (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 3,184,285.16** (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar më datë 02.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

III.1.2. Në datë 29.07.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit).

1. JUBICA SHPK
2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK
3. ROZAFA 94
4. I.D.K-KONSTRUKSION

III.1.3. Në datën 20.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ku rezulton se BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK, është i skualifikuar.

- | | |
|--|----------------|
| 1. JUBICA SHPK | I Kualifikuar |
| 2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK | I Skualifikuar |

3. ROZAFI 94

I Skualifikuar

4. I.D.K-KONSTRUKSION

I Skualifikuar

III.1.4. Me datë 29.10.2024, në Vendimin nr.1515/2024 datë 29.10.2024 Komisioni vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-10943-06-24-2024, me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me fond limit 319,256,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt – ankimi.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi si dhe Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në lidhje bashkimit të operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk.

4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk.

6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

8.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.5. Në datën 01.11.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për rivlerësimin e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ku rezulton se BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK, është i kualifikuar pas zbatimit të vendimit të KPP-së nr.1515/2024 datë 29.10.2024.

1. JUBICA SHPK

I Kualifikuar

2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK

I Kualifikuar

III.1.6. Në datë 12.11.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar ftesën për tender, për fazën e dytë, të procedurës së mësipërme të prokurimit duke iu drejtuar operatorëve ekonomikë të kualifikuar:

1. JUBICA SHPK

2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK

III.1.6.1. Në datë 02.12.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e dytë, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

1. JUBICA SHPK

2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK

III.1.6.2. Në datë 13.12.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e propozimeve ekonomiko-teknike dhe dhënien e pikëve operatorëve ekonomikë të kualifikuar në këtë fazë, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

- | | |
|--|---------------|
| 1. JUBICA SHPK | 296,9994 pikë |
| 2. BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK | 297 pikë |

III.1.7. Në datë 24.12.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 90, datë 30.12.2024, ku është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK

III.1.8. Në datën 30.12.2024 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 3788/2024, datë 18.12.2024 dhe numër elektronik A/2024/4940, datë 30.12.2024, e operatorit ekonomik “JUBICA” SHPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

III.1.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3788/2 prot., datë 31.12.2024 ku u konstatua se, objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi shpalljen fitues në procedurën e shortit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK”, si dhe kundërshtimin e vlerësimit me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK”, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.10. Më datë 06.01.2025, operatori ekonomik “JUBICA” SHPK ka dërguar “Formular ankese”, nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar ankesa me nr. 3788/3, datë 06.01.2025.

III.1.11. Më datë 07.01.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, ka depozituar pranë KPP-së, “Formular Argumentesh”, nëpërmjet postës elektronike, protokolluar me nr. 3788/4, datë 07.01.2025.

III.1.12. Më datë 09.01.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK”, ka depozituar pranë KPP-së, “Formular Argumentesh”, nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me nr. 3788/5, datë 09.01.2025.

III.1.13. Në datën 10.01.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga operatori ekonomik “JUBICA” Shpk me nr. Aplikimi A/2024/4940, të paraqitur në Sistemin e Ankesave Elektronike”, të protokolluar me tonën me nr. 3788/6 prot, datë 10.01.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e **ka pranuar pjesërisht** ankesën e ankimuesit.

III.1.14. Me shkresën nr. 3788/7 prot., datë 15.01.2025, KPP iu drejtuar autoritetit kontraktor ARRSH, nëse BOE “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” SHPK si subjekt i interesuar, ka dorëzuar apo jo “Formular Argumentesh”, pranë autoritetit kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar? A e keni njoftuar BOE “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” SHPK si subjekt i interesuar, mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Jubica”SHPK? Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.

III.1.15. Me shkresën përcjellëse me nr. 189/1 prot., datë 13.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3788/8 prot., datë 16.01.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacioni nëpërmjet shërbimit postar.

III.1.16. Me shkresën nr. 3788/9 prot., datë 27.01.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor për ti kërkuar informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave për çdo fazë, procesverbali i hedhjes së shortit, si dhe të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “JUBICA” SHPK, të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.17. Me shkresën përcjellëse me nr. 473/1 prot., datë 27.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3788/10 prot., datë 29.01.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse “Kthim përgjigje”, në lidhje me shkresën nr. 3788/7 prot., datë 15.01.2025 të KPP-së.

III.1.18. Me shkresën përcjellëse me nr. 784/1 prot., datë 06.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 3788/11 prot., datë 10.02.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse “Kthim përgjigje”, në lidhje me shkresën nr. 3788/9 prot., datë 27.01.2025 të KPP-së.

III.1.19. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, janë paraqitur argumentet nga BOE i interesuar “Varaku E & Ndërtuesi 2014” SHPK, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, nëpërmjet adresës elektronike të KPP-së si dhe shërbimit postar, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.20. Në datë 03.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.325/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “JUBICA” Shpk, për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-10943-06-24-2024, me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me fond limit 319,256,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.21. Me shkresën nr. 2006/1 prot., datë 21.03.2025, protokolluar me tonën nr. 3788/17 prot., datë 21.03.2025, autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 325/2025, datë 03.03.2025, si vijon: “...Referuar shkresës tuaj nr. 3788/15 prot., datë 03.03.2025 me lëndë “dërgim Vendimi”, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)”, me Nr. REF-10943-06-24-2024, po ju dërgojmë procesverbalin mbi rivlerësimin e propozimit ekonomiko-teknik, nga komisioni i vlerësimit të ofertave”.-procesverbal nr. 5 datë 21.03.2025 mbi rivlerësimin e ofertave të paraqitura;

III.1.22. Në datë 03.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.325/2025, ku vendosi:

1. Autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.325/2025, datë 03.03.2025.
2. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës të prokurimit prokurimit, Loti 1, me Nr. REF-10943-06-24- 2024, me objekt të lotit: “Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)”, me fond limit të lotit 319,256,430 (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH ose 3,184,285.16 (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) Euro pa TVSH zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar, deri në shqyrtimin e plotë të ankesës së subjektit të interesuar të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

III.1.23. Në datën 25.03.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 793/2025, datë 25.03.2025 dhe numër elektronik A/2025/5179, datë 25.03.2025, e nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK” në procedurën e prokurimit sipërcituar.

III.1.24. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 793/1 prot., datë 26.03.2025 ku u konstatua se, nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vlerësimit me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & Varaku E SHPK” dhe operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.25. Më datë 06.01.2025, operatori ekonomik “JUBICA” SHPK ka dërguar “Formular i paraqitjes së argumentave”, ardhur nëpërmjetë sisemit elektronik, protokolluar me nr. 793/2 prot., datë 02.04.2025.

II.26. Me shkresën me nr. 793/3 prot., datë 02.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor, ku referuar pikës 4 të nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke i kërkuar informacion lidhur mbi vendimin e marrë mbi trajtimin e ankesës.

III.1.27. Me shkresën nr. 2846/1 prot., datë 08.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 793/4 prot., datë 10.04.2025, autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje shkresës me nr. 793/3 prot., datë 02.04.2025 duke argumentuar se: “.....ju bëjmë me dije se, ankesa nuk është marrë në konsideratë, pasi autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësim të procedurës në përputhje dhe në zbatim të plotë të Vendimit nr. 325/2025 datë 03.03.2025 të KPP-së, duke e faktuar dhe dokumentuar me shkresën nr. 2006/1 prot., datë 21.03.2025, me lëndë “Zbatim vendimi”.

III.1.28. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se në datën 25.03.2025, datë në të cilën operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor nuk ka publikuar as njoftimin e fituesit, as njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

III.1.29. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ndryshuar, parashikon se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

III.1.30. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.31. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. **Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.**

III.1.32. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.33. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.1.34. Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik”.

III.1.35. Në nenin 115 pika 1, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.”

III.1.36. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: “a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”*

III.1.37. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK, ka dorëzuar në datën 25.03.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, formularin e ankesës së protokolluar me nr. 793/2025, datë 25.03.2025. Ndërkohë nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor në këtë datë, pra 25.03.2025, nuk është publikuar as njoftim - fituesi e as njoftimi i anulimit të procedurës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*, pasi në datën 25.03.2025 (data që operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën online), nuk ishte publikuar as njoftim fituesi e as njoftimi i anulimit të procedurës. Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret, më datë 25.03.2024, afati i paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nuk kishte filluar ende, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, apo njoftimi i anulimit të procedurës, që do të thotë se operatorit ekonomik ankimues nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit. Për sa më sipër, ankesa dorëzuar në datën 25.03.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dy institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në sistemin e ankesave elektronike, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit në autoritet

kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. KPP, me këtë rast, gjen me vend të theksojë se, ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë por edhe me Kushtetutën si ligji më i lartë në vend referuar parashikimeve të nenit 4/2 të saj. Kushtetuta vetë parashikon hierarkinë, statusin dhe efektin e normave ligjore. Kuadri kushtetues ka parashikuar hierarkine e normave ligjore në nenin 116 të Kushtetutës në të cilin parashikohet se: *“1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:*

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.” Në këtë kuadër Kushtetuta vetë, duke folur për hierarkinë e akteve normative në nenin 116 të saj, parashikon akte normative që janë “nën” ligjet sic është në rastin konkret VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në këtë mënyrë, duke qenë se ligjet kanë epërsi mbi aktet normative të Këshillit të Ministrave, KPP në vendimarrjen e tij i qëndron strikt këtij rregullimi si organi më i lartë në fushën e prokurimit publik, i cili ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse duke llogaritur afatet e ankimit të operatorëve ekonomikë sipas parashikimeve të nenit 110 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

III.1.38. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: *“ Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”*. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndtushuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik

Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-10941-06-24-2024, me objekt “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” (ndarë në 15 lote)”, me fond limit 2,966,127,447 (dy miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë gjashtë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSH ose 29,584,355.14 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë katërmëdhjetë) Euro pa TVSH, Loti 1, me Nr. REF-10943-06-24- 2024, me objekt të lotit: “Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)”, me fond limit të lotit 319,256,430 (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH ose 3,184,285.16 (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 02.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini	Anila Malaj

Kryetar

Jonaïd Myzyri

